



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. 7369 prot.

Roskovec, më 24.12.2020

VENDIM

Nr. 102 Datë 24.12.2020

“PER

**MIRATIMINE STRUKTURES ORGANIZATIVE DHE PAGAT PERKATESE
PER BASHKINE ROSKOVEC DHE NJESITE ADMINISTRATIVE KUMAN, KURJAN
DHE STRUM, SI DHE ORGANOGRAMES PER VITIN 2021”**

Ne mbeshetje te Ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 “Per vetqeverisjen vendore” neni 8 , pika 2 dhe neni 64 , germa “j” ; te ligjit 152/2013 “Per Nepunesin Civil” (i ndryshuar) neni 50 ; te Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; te Vendimit nr.124, date 17.02.2016 te Keshillit te Ministrave “Per Pezullim dhe Lirim nga Sherbimi Civil”; te Vendimit nr.125 date 17.02.2016 te Keshillimit te Ministrave “Per Transferimin e Perkohshem dhe te Perhershem te Nepunesve Civil”, si dhe te Vendimit te Keshillit Bashkiak nr.89 datë 02.12.2020 “Per miratimin e buxhetit , numrit maksimal te punonjesve te Bashkise dhe te Ndermarrjeve vartese si dhe te nivelit maksimal te pagave per vitin 2021” , miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkrese nr.1246/1 prot.date 17.12.2020,

VENDOSA:

1. Miratimin e Struktures Organizative te Bashkise Roskovec dhe Njesive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum per vitin 2021 sipas lidhjes nr.1 bashkelidhur.
2. Miratimin e Organogrames (hierarkia dhe varesia e pozicioneve) te Bashkise Roskovec dhe Njesive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum per vitin 2021 sipas lidhjes nr.2 bashkelidhur.
3. Numri i pergjithshem i punonjesve te Bashkise Roskovec eshte gjithsej 184 (njëqind e tetëdhjete e katër) i kategorizuar si me poshte:
 - o Kryetari - 1 (një)
 - o Kabineti i kryetarit - 8 (tetë)
 - o Sherbimi civil – 52 (pesëdhjetë e dy)
 - o Punonjes Administrativ dhe Mbeshtetes 123 (njëqind e tetëdhjetë e tre)



4. Efektet financiare ne paga dhe sigurime shoqerore do te perballohen nga fondi perkates ne buxhetin e vitit 2021.
5. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 01.01.2021.
6. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore dhe Drejtoria Ekonomike.
7. Ngrakohet Sektori i Sekretari-Arkivit te kryejë njoftimet perkatëse.
8. Ndjek zbatimin e ketij Vendimi Sekretari i Pergjithshem znj.Evisa Gishto.
9. Ky vendim hyn ne fuqi ne datën e miratimit nga ana e Prefektit të Qarkut.

KRYETAR
Majlinda Buri

